



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*  
*Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju*  
*Ministry of Education, Science and Technology*

# **PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË PUNËS SË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË PËR VITIN 2015**

---

---



Kosova ka zhvilluar sistemin arsimor në të gjitha nivelet, ku theks të veçantë meritojnë arritjet në përfshirje të nxënësve në këtë sistem. Sot, mesatarisht 9 nga 10 fëmijë ndjekin arsimin fillor, 8 nga 10 fëmijë ndjekin arsimin e mesëm, 5 nga 10 të rinjë ndjekin arsimin e lartë.

Rreth 17% e buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës ndahet për arsim (€263 milion). Investimi në arsim në krahasim me vitin 2010 është rritur për rreth 30%. Kosova ka 23.830 mësimdhënës, 382.000 nxënës dhe 122.000 studentë. Hapësira fizike për nxënës është përmirësuar për 15% . Raporti mësues për nxënës është përmirësuar për 16%.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjatë kësaj periudhe një (1) vjeçare 2014-2015 është angazhuar në zbatimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e arsimit, si dhe përbushjen dhe realizmin e objektivave, programeve dhe projekteve në arsim, si pjesë e dokumenteve strategjike të MASHT.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, gjatë këtij viti, me mbështetjen e partnerëve zhvillimor ndërkombëtarë, përmes një procesi gjithëpërfshirës ka filluar hartimin e Planit Strategjik për Arsim në Kosovë për periudhën 2017-2021, i cili do të jetë në përputhje me programin qeverisës dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim.

ARSIMI  
PARAUNIVERSITAR

Në **Arsimin Parashkollor**, kemi zhvilluar një qasje të integruar ndaj edukimit në fëmijërinë e hershme, në të cilën kombinohen procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit, lojës së fëmijëve dhe kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre. Me qëllim të promovimit të edukimit gjithëpërfshirës parashkollor në Kosovë, gjatë vitit 2015 kemi arritur bashkëpunim me CARITAS-in Zvicëran për mobilimin e 150 klasave para-fillore me pajisje moderne si dhe trajnimin cilësor të edukatorëve.

Në **Arsimin Fillor dhe të Mesëm**, kemi vazhduar zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca në 8 % të shkollave. Kurrikula e re është pilotuar për herë të parë në vitin shkollor 2013/2014 në 10 shkolla, duke u zgjeruar më tutje në vitin 2014/2015 në 85 shkolla tjera fillore dhe të mesme. Nga 95 shkollat e përfshira në pilotim të kurrikulës në vitin 2015, mbi 3100 mësime janë trajnuar dhe çertifikuar për zbatimin e kurrikulës së re. Zhvillimi i planprogrameve lëndore për klasat pilotuese, rishikimi i përmbajtjeve të teksteve shkollore dhe përgatitja e materialeve tjera për mësimdhënie, zbatimi i praktikave të reja të vlerësimit të njohurive të nxënësve dhe aktivizimi i aktiveve profesionale në shkollat pilotuese, janë disa aspekte me rëndësi të këtij procesi.

Arritshmëria e nxënësve në teste kombëtare është përmirësuar për 8% krahasuar me vitin 2011. Numri i përgjithshëm i maturantëve, të cilët kanë kaluar provimin është 25.551 maturantë, apo 79.9%. Nuk ka pasur ulje të kriterit të kalueshmërisë në Provimin e Maturës Shtetërore 2015. Testit të Maturës i janë nënshtruar rreth 33 mijë nxënës në 250 qendra të testimit dhe është administruar nga rreth 2,500 administrues, 800 komisionarë dhe 500 mbikëqyrës, ndërsa në afatin e dytë, testit i janë nënshtruar mbi 16 mijë maturantë. Të gjitha raportet dëshmojnë për një avancim të dukshëm në pjesën përgatitore dhe zbatuese të administrimit të Testit të Maturës 2015, falë mobilizimit dhe seriozitetit të lartë në insistimin për të siguruar mbarëvajtje të administrimit të Testit të Maturës.

Gjatë vitit 2015, MASHT për herë të parë ka marrë pjesë në vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve (PISA) që është një vlerësim ndërkombëtar për njohuritë e nxënësve 15-vjeçarë në lexim, matematikë dhe shkencë.

Këtë vit, kemi nënshkruar marrëveshjen për marrjen e kredisë së butë me Bankën Botërore, në vlerë prej USD11 milion për Projektin e ripërmirësimit të Sistemit të Arsimit në Kosovë, për një periudhë 4 vjeçare të implementimit, që do të mbështetet përmirësimin e kapaciteteve për planifikim strategjik, menaxhim financiar, monitorim dhe vlerësim në sektorin e arsimit parauniversitar, grantet për zhvillimin e shkollave, përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese të institucioneve shkollore për përmirësimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe përmirësimin e

kapaciteteve të institucioneve kryesore për monitorimin e rezultateve mësimore dhe të vlerësimit të mësimin të nxënësve.

Si pjesë e zbatimit të Kontratës Kolektive, MASHt ka promovuar kontratat e para të përhershme për mësimdhënës, unike për të gjithë mësimdhënësit e nivelit parauniversitar në Kosovë, që synojnë të mbrojnë punën e mësimdhënësve dhe të drejtat e tyre. Poashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka aprovuar dhe ka filluar të zbatojë pagesën 0.5% për përvojën e punës për të gjithë punëtorët e arsimit.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit është shënuar një bashkëpunim i mirë me Republikën e Shqipërisë në institucionalizimin e mësimin plotësues në diasporë, duke përkrahur fëmijët e diasporës dhe të mërgatës, përmes furnizimit me libra dhe mbështetje të aktiviteteve të ndryshme edukativo-arsimore, me qëllim të ruajtjes së gjuhës dhe të identitetit kombëtar. Bashkëpunimi me Shqipërinë po vazhdon edhe në zhvillimin profesional për unifikimin e kurrikulave. Gjithashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me Shqipërinë në fushën e përafrimit të kurrikulës për arsimin parauniversitar, me theks të veçantë në rishikimin e Kornizës së Kurrikulës, planit mësimor, planprogrameve për lëndë dhe klasë, praktikat e vlerësimit të nxënësve dhe reformimit e avancimit të cilësisë së teksteve shkollore.

Gjatë vitit 2015, është hartuar dhe miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, e cila parasheh masa konkrete për përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit, për ndërtimin e mekanizmave efektiv për sigurimin e cilësisë, ngritjen e sistemit efikas për vlerësim të shkollës, fuqizimin e organeve shkollore (aktivet dhe këshillat), funksionalizimin e sistemit të licencimit të mësimdhënësve, planifikimin zhvillimor dhe monitorimin e zbatimit të tyre, për punësimin e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, për rezultatet e testeve kombëtare dhe ndërkombëtare, për digjitalizimin e shkollave dhe promovimin e sukseseve, si dhe shpërblimin e arritjeve. Gjatë katër viteve të ardhshme të zbatimit të kësaj Strategjie, në të gjitha shkollat publike do të angazhohen koordinatorët e përhershëm të cilësisë, të cilët do të jenë përgjegjës për planifikimin e zhvillimit të cilësisë në nivel shkollë dhe komune.

Gjatë vitit 2015, me qëllim të përmirësimit të kushteve për mësimdhënie dhe nxënie është vazhduar me ndërtimin e 20 objekteve të reja shkollore për nivelin parauniversitar, të gjitha të pajisura me inventarin e nevojshëm shkollor. Këto objekte përfshijnë komunat: Viti, Deçan, Dragash, Ferizaj, Lipjan, Prizren, Mitrovicë, Podujevë, Suharekë, Kaçanik, Pejë.



Gjatë vitit 2015, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka themeluar për herë të parë Këshillin e Ekspertëve të programeve dhe teksteve shkollore, i cili ka filluar punën në procesin e rishikimit/përgatitjes së teksteve të reja shkollore bazuar në programet kurrikulare për klasë dhe lëndë të caktuara dhe mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve për tekste shkollore nga autorët e teksteve dhe shtëpitë botuese.

Gjatë kësaj periudhe, MASHT në bashkëpunim me partnerët zhvillimor ndërkombëtarë ka filluar zbatimin e dy projekteve të rëndësishme për integrimin e teknologjisë informative në sistemin arsimor, përkatësisht krijimin e platformave të hapura, zhvillimin e materialeve me përmbajtje elektronike për shkollat tona dhe zbatimin e platformave për digjitalizimin e përmbajtjeve mësimore në formë audio-vizuale të programit shkollor. Kosova ka filluar me realizimin e projektit “TIK dhe Mësimi Elektronik në Arsim” dhe “Digjitalizimi i Maturës dhe E-edukimi” dhe janë mbështetur mbi 190 shkolla në gjithë Kosovën me furnizimin me pajisje moderne të teknologjisë (€1.5milion). Poashtu, në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë Informative është zhvilluar dhe zgjeruar zbatimi i aplikacionit e-shkolla. Ky aplikacion digjitalizon të gjithë procesin mësimor, në sistemin shkollor parauniversitar, duke filluar nga: digjitalizimi i librit amë në shkolla; digjitalizimi i ditarit dhe punëve në ditar; digjitalizimi i orarit; digjitalizimi i dokumenteve (certifikatave, librezave në bazë të notimeve në ditar; digjitalizimi i regjistrit të nxënësve, arsimtarëve;

digjitalizimi i regjistrit të lëndëve mësimore; digjitalizimi i regjistrit të shkollave, klasave dhe inventarit; digjitalizimi i kurrikulave shkollore, planprogrameve; digjitalizimi i realizimit të planprogrameve për secilin arsimtar veç e veç.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë edhe gjatë këtij viti i ka kushtuar rëndësi të veçantë arsimimit të komuniteteve, përmes sigurimit të teksteve shkollore dhe përkrahjes përmes bursave për shkollim. MAShT ka mbështetur arsimimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian përmes ndarjes së 550 bursave për nxënës dhe 35 bursave për studentë të këtyre komuniteteve.

Poashtu, rëndësi e veçantë i është kushtuar arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Është rritur dukshëm numri i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në sistemin arsimor dhe aktualisht arrinë në 6.093 nxënës në vitin 2014/2015. Prej tyre, 109 fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në institucionet parashkollore, 4.862 në shkolla fillore/mesme, 1.122 në qendra burimore dhe klasat e bashkëngjitura. Aktualisht, kemi 7 qendra burimore, të cilat shërbejnë për nxënësit me dëmtime të rënda dhe të shumëfishta dhe në ofrimin e mësimave dhe shërbimeve profesionale mbështetëse për nxënës me nevoja të veçanta.

Është punuar shumë në ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në shkolla duke trajnuar 5.860 mësimdhënës dhe edukatorë në programe të ndryshme me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, përkatësisht për punën me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Në **Arsimin Profesional**, gjatë vitit 2015 MASHt ka filluar projektin për harmonizimin e arsimit me kërkesat e tregut të punës në Kosovë, me mbështetjen nga Bashkimi Evropian dhe Agjencioni Austriak për Zhvillim dhe në kuadër të këtij projekti është realizuar vlerësimi i nevojave për shkathtësi në tregun e punës.

Autoriteti Kosovar për Kualifikime Kombëtare është anëtar i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe së fundi është anëtarësuar në Grupin Këshillëdhënës për Kornizën Evropiane për Kualifikime (EQF), detyrë e të cilit grup është zhvillimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i politikave të EQF. Fondacioni Evropian për Trajnime, në raportin e tij për 2015, përmend Autoritetin e Kualifikimeve Kombëtare dhe në përgjithësi Kosovën si vendin më të avancuar në rajon për implementimin e Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare. Kosova për herë të parë do të përfshihet në hulumtimet dhe publikimet e Qendrës Evropiane për Zhvillim të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (CEDEFOP) lidhur me Kornizat Kombëtare. CEDEFOP është agjenci e Bashkimit Evropian, e cila mbështetë zhvillimin e politikave evropiane të arsimit dhe aftësimin profesional.

Mendihmënepartnerëzvhillimorë(LuxDevelopment), gjatë vitit 2015 janë zhvilluar materialet mësimore për rreth 150 module të Qendrave të Kompetencës në Prizren dhe Ferizaj, bazuar në kurrikulat mësimore të rishikuara sipas Standardeve Profesionale për profilet e Ekonomisë, Tregtisë, Turizmit, Optikës, Ortodontisë, etj.

Një Ekip Teknik i themeluar si trup i veçantë, i përbërë nga specialistë të arsimit dhe aftësimit profesional, ka hartuar Konceptin për Vizionin mbi Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Poashtu, ka filluar procesi për hartimin e Kornizës së Kurrikulës për Arsim dhe Aftësim Profesional, i cili me përkrahjen e partnerëve zhvillimorë pritet të përfundojë brenda vitit 2016.

Gjatë këtij viti, me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të mëtejme të shkathësive profesionale praktike të nxënësve të shkollave të mesme profesionale, ka filluar bashkëpunimi me Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), për realizimin e programit të përbashkët "Programi teknik industrial", që ofron praktikë profesionale në ndërmarrje për nxënësit e shkollave të mesme profesionale në arritjen e kompetencave profesionale. Poashtu, ka filluar bashkëpunimi për pilotimin e sistemit, me elemente të arsimit dual, në mes të Shkollës Profesionale në Suharekë dhe Kompanisë Solid në fushën e përpunimit të këpucëve dhe hotelerisë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies  
Sociale është përgatitur dhe ka filluar zbatimi i Strategjisë  
për Edukim dhe Orientim në Karrierë.

ARSIMI I LARTË  
DHE SHKENCA

Në **Arsimin e Lartë**, gjatë vitit 2015, MASHT është angazhuar në garantimin e autonomisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë, si kusht thelbësor në rritjen e cilësisë në arsimin e lartë. Janë mbështetur me masa konkrete universitetet publike në programet mësimore dhe në administrimin e buxheteve, në mënyrë që universitetet t'i përdorin në mënyrë sa më efektive burimet materiale që i zotërojnë.

Gjatë kësaj periudhe, është ndërtuar pajtueshmëri dhe plan koordinimi me Universitetin e Prishtinës, për të ofruar mbështetjen me kuadro akademike edhe në një kohë të caktuar për të ndihmuar universitetet e reja publike. Kjo mbështetje është konkretizuar me marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga Universiteti i Prishtinës me Universitetin e Gjakovës, Universitetin e Gjilanit, Universitetin e Mitrovicës dhe Universitetin e Prizrenit.

Me mbështetjen dhe mbikëqyrjen e MASHT, për herë të parë janë organizuar me sukses zgjedhjet në tri (3) universitetet publike në Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë për zgjedhjen e organeve drejtuese të Universitetit.

Gjatë vitit 2015, është themeluar "Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj", si institucion publik i arsimit të lartë, i cili do të funksionojë si një universitet specifik, unik në Kosovë, i orientuar në drejtime profesionale, me potencial të madh për krijimin e kuadrove të reja profesionale dhe akademike, të cilat janë të nxitura nga tregu i punës.

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka filluar punën në programet e studimit: Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobileve, Inxhinieria Industriale me Informatikë, Menaxhmenti Industrial dhe Menaxhimi i Hotelerisë dhe Turizmit.

Në qershor 2015, MAShT ka unifikuar pagat dhe shtesat e të gjithë kryetarëve/ kryesuesve dhe anëtarëve të Këshillave Drejtuese të të gjitha institucioneve publike të arsimit të lartë dhe instituteve shkencore.

Gjatë këtij viti, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka filluar të zhvillojë konceptin dhe formulën financiare në arsimin e lartë.

Gjatë këtij viti, për herë të parë është përgatitur dhe funksionalizuar Sistemi për Menaxhimin të Dhënave në Arsimin e Lartë (SMIAL).

Me qëllim të rritjes së cilësisë, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" këtë vit akademik 2015/2016, është realizuar rritja dhe zvogëlimi i numrit të studentëve në fusha të caktuara të studimit për të reflektuar në nevojat e tregut të punës dhe bazuar në kapacitetet kadrovike të Universitetit. Kryesisht, kjo platformë ka rezultuar në zvogëlimin e numrit të studentëve të regjistruar në vitin e parë të studimeve nga shkencat sociale, për 2.724 studentë. Në gjitha universitetet publike në Kosovë, në vitin akademik 2015/2016 janë regjistruar 15,515 studentë.



Gjatë vitit 2015, në bashkëpunim dhe bashkëfinansim me USAID janë ndarë 89 bursa për studime Master në SHBA, si dhe përmes Programit të Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare (CEEPUS), janë mbështetur dhjetëra mobilitete jashtë vendit të stafit akademik. Janë ndarë rreth 130 bursa studimi për studentët kosovarë për studime në universitetet më të mira botërore.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me qëllim të nxitjes dhe stimulimit të studentëve në fusha të ndryshme të orientuara në degë të rëndësishme strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, me fokus të veçantë në shkencat ekzakte, bujqësi, inxhinieri, mjekësi, shkencat matematiko-natyrore dhe edukim, ka ndarë rreth 750 bursa për studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë në programet deficitare.

Gjatë vitit 2015, Agjencia e Kosovës për Akreditim është pranuar në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), që paraqet një arritje shumë të rëndësishme për ndërkombëtarizmin e arsimit të lartë në Kosovë dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë, si një mundësi e re për ndërlidhjen e institucioneve dhe studentëve tanë në sistemin evropian të arsimit të lartë.

Puna e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), gjatë vitit 2015 ka përfshirë vlerësimin, akreditimin, si dhe monitorimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë. Janë pranuar 202 aplikacione nga institucionet publike dhe private të arsimit të lartë për ri/akreditimin e programeve të studimit në nivelin BA, MA dhe PhD. Nga 202 aplikacionet për programe të studimit, 91 kanë qenë aplikime për akreditim për herë të parë, ndërsa 111 aplikime për riakreditim. Të gjitha aplikacionet e IAL-ve, janë trajtuar dhe në bazë të raporteve të vlerësimit të hartuara nga ekspertët ndërkombëtarë të vlerësimit, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ka vendosur që të refuzojë 87 programe të studimit dhe të riakreditojë 113 programe të studimit.

**Për institucionet publike të arsimit të lartë, KShC ka vendosur si në vijim:**

- Të refuzojë 35 programe të studimit;
- Të riakreditojë 51 programe të studimit.

**Për institucionet private të arsimit të lartë, KShC ka vendosur si në vijim:**

- Të refuzojë 52 programe të studimit;
- Të riakreditojë 62 programe të studimit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, gjatë vitit 2015, ka mbyllë të gjitha institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë vepruar pa akreditim dhe pa licencë, në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të zgjerimit dhe përmirësimit të kushteve të studimeve, këtë vit ka filluar ndërtimi i Konviktit 8 në Qendrën Studentore në Prishtinë. Qendra e Studentëve në Prishtinë ka ofruar shërbime të mira për rreth 3.500 studentët banues në konvikte.

Në fushën e **Shkencës**, gjatë vitit 2015, në kuadër të Fondit të Shkencës (€570.000) është mbështetur puna kërkimore dhe shkencore përmes granteve për projekte të vogla shkencore (14 projekte), granteve për publikime shkencore (8 publikime shkencore), granteve për publikime në revista me impakt faktor (5 publikime), granteve për mobilitete afatshkurtëra (42). Kosova ka filluar të jetë aktive në Programin Kornizë të BE-së për Kërkim dhe Inovacion - Horizon 2020. 4 projekte janë fituar nga aplikuesit nga Kosova. Poashtu, gjatë kësaj periudhe, MAShT ka hartuar Strategjinë e Inovacionit të Kosovës.

REFORMA  
LEGJISLATIVE  
NË ARSIM

**Gjatë periudhës një (1) vjeçare, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka punuar në ndryshime substanciale të legjislacionit për arsim, duke rishikuar/hartuar 6 projektligje:**

1. Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore, i miratuar nga Kuvendi.
2. Projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, i miratuar në Qeveri dhe i dorëzuar për shqyrtim/miratim në Kuvend.
3. Projektligji për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës, i miratuar në Qeveri dhe i dorëzuar për shqyrtim/miratim në Kuvend.
4. Ligji për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi.
5. Projektligji për Statusin e Punëtorëve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, i dorëzuar për shqyrtim/miratim në Qeveri.
6. Projektligji për Inspektoratin e Arsimit, i finalizuar për dorëzim në Qeveri në vitin 2016.

## **Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore**

– Ky ligj rregullon mënyrën e organizimit, përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe procedurat e mbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore. Reforma në këtë ligj, përkrahë heqjen e kushtëzimit të marrjes së diplomës së shkollës së mesme të lartë me kalimin e pragut të kalueshmërisë, duke marrë parasysh që kjo do të ndikonte negativisht veçanërisht tek nxënësit, të cilët përfundojnë shkollimin në shkollat e mesme profesionale, e të cilat përbëjnë shumicën e shkollimit të mesëm në Kosovë. Është përcaktuar që të gjithë nxënësit e gjimnazeve, të cilët me sukses e kanë përfunduar vitin e fundit, pajisen me diplomë dhe i nënshtrohen Provimit të Maturës Shtetërore, si dhe të gjithë nxënësit që kanë kryer me sukses provimin përfundimtar të arsimit profesional, pajisen me diplomë. Ata që dëshirojnë regjistrimin në arsim të lartë, i nënshtrohen Provimit të Maturës Shtetërore. Pragu i kalueshmërisë në Provimin e Maturës Shtetërore është caktuar të jetë 40%, ndërsa institucionet e arsimit të lartë do të bëjnë pranimin e studentëve në bazë të rezultateve të arritura: 30% gjatë shkollimit të mesëm të lartë; 30% në Provimin e Maturës Shtetërore; 40% në vlerësimin e brendshëm të njësive akademike. Në zbatim të këtij Ligji, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të themelojë në fillim të vitit të ardhshëm Agjencinë e Kosovës për Standarde dhe Vlerësim.

## **Projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës**

– Ky projektligj përcakton parimet, objektivat kryesore dhe organizimin e arsimit të lartë, përfshirë rregullat për krijimin, organizimin, funksionimin, financimin, akreditimin dhe licencimin e institucioneve të arsimit të lartë, me qëllim të sigurimit të transparencës, cilësisë dhe zhvillimit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në përputhje me standardet më të mira evropiane. Reforma në këtë projektligj përkrahë ndryshime thelbësore në arsimin e lartë, si: modernizimin e qeverisjes së institucioneve publike të arsimit të lartë; krijimin e fondeve të posaçme të bursave për studentët që ndjekin degët me prioritet kombëtar dhe me rezultate të shkëlqyera; fuqizimin e qeverisjes, autonomisë dhe llogaridhënien e institucioneve të arsimit të lartë; proflizimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe ndërlidhjen me tregun e punës dhe avancimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë.

## **Projektligji për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës**

– Ky projektligj do të shërbejë si instrument i rëndësishëm i ngritjes së cilësisë në profesionet e caktuara, për ushtrimin e të cilave, pas diplomës do të duhet nënshtruar edhe provimit kombëtar të profesionit, sipas standardeve evropiane të organizimit dhe monitorimit për profesionet e rregulluara. Profesionet, të cilat fillimisht do të rregullohen me këtë Ligj në Republikën e Kosovës janë: profesioni i mjekut, stomatologut, farmacistit, infermierit, mamisë, fizioterapeutit, veterinerit, arkitektit, inxhinierit, mësime dhënësit të arsimit parauniversitar, psikologut dhe punëtorit social.



### **Projektligji për Statusin e Punëtorëve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës**

– Ky projektligj ka për qëllim njohjen e sistemit arsimor të Republikës së Kosovës që nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, përkatësisht përcaktimin e statusit dhe njohjen e stazhit të benificuar me përkrahje financiare, përmes pensioneve dhe benificioneve të veçanta për kategoritë që ndërtuan sistemin e pavarur të arsimit shqiptar dhe organizuan mësimin në kushte të okupimit klasik prej vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

MARRËVESHJE  
NDËRKOMBËRARE NË  
ARSIM NË VITIN 2015

- Marrëveshje e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për organizimin e përbashkët të Mësimit të Gjuhës Shqipe dhe të Kulturës Shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë.
- Marrëveshje e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
- Marrëveshje e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për bashkërendim institucional për Përparimin dhe Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve në Arsimin Parauniversitar.
- Programi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim në fushën e Arsimit dhe Shkencës.

- Protokoll i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Sportit të Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin në fushën e arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë.
- Marrëveshje e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Lartë të Arsimit të Republikës së Turqisë për bashkëpunim në fushën e arsimit të lartë dhe shkencës.
- Marrëveshja Rajonale për themelimin e Qendrës së Ballkanit Perëndimor për Hulumtime dhe Inovacion për mbështetjen dhe fuqizimin e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar të Ballkanit Perëndimor në hulumtim dhe inovacion. Marrëveshja është nënshkruar nga Ministrat e ministrive përkatëse për arsim nga Kosova, Shqipëria, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi.

- Marrëveshje bashkëpunimi me universitetet e njohura “James Madison University”, “Eastern Mennonite University”, “Christopher Neëport University” për bashkëpunim për asistencën e këtyre universiteteve në reformimin e sistemit arsimor në Kosovë.

ARSIMI  
NË SHIFRA


Në vitin shkollor 2015/16 janë regjistruar 374,407 nxënës në nivelin parauniversitar, prej të cilëve 367,940 nxënës në arsimin publik dhe 6,467 në arsimin privat.

Niveli	Publik						Privat			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Arsimi parashkollor (mosha 0-<5)	2031	1884	3915	474	403	877	2505	2287	4792	11483	10649	22132
Arsimi paraafilior (mosha 5-<6)	11221	10434	21655	262	215	477	134842	126265	261107	43976	41010	86376
Fillor/ mesëm i ulët	133297	125167	258464	1545	1098	2643	194196	180211	374407	190525	177415	367940
I mesëm i lartë	43976	39930	83906	1390	1080	2470	6467	2796	9267			
Gjithsej	190525	177415	367940	3671	2796	6467						

**Tab.1. Numri i nxënësve sipas niveleve**

Në total, femrat përbëjnë 48.1% të pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar dhe kjo përqindje është më e lartë se në arsimin e mesëm të lartë, ku femrat përbejnë 47.5%.


Pjesëmarrja në arsimin parauniversitar (fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë) në vitin shkollor 2015/16 është në shkallë të kënaqshme dhe është në nivelin e vendeve në rajon. Në këtë vit kemi një rritje të konsiderueshme të fëmijëve të kyçur në nivelin parashkollor (mosha 3-<6) që është 30.9%, ndërsa në nivelin parafillor (5 vjeç) është 81.3%.




**Graf. 1. Shkalla bruto e regjistrimit sipas niveleve arsimore**



Numri i nxënësve në shkolla profesionale dhe gjimnaze, nga gjithsej 86,376 nxënës, 42,973 ose 49.8% janë nxënës të shkollave profesionale, ndërsa 43,403 ose 50.2% janë nxënës në gjimnaze.




**Graf. 2. Përqindja e nxënësve ne arsimin e mesëm të lartë sipas gjinisë dhe tipit të shkollave në përqindje**



**Graf. 3. Nxënësit sipas përkatësisë etnike në përqindje**

Nga gjithsej 28,103 personel arsimor, 23,366 janë mësimdhënës, 1,654 personel administrativ dhe 3,083 janë personel ndihmues.



**Graf. 4. Personeli arsimor sipas gjinisë për nivele**

Niveli	Amë	Par. ndar	Gjithsej
Parashkollor/Çerdhe	36	7	43
Filllore/mesme të ulta	633	336	969
I mesëm i lartë	104	15	119
Shk. Speciale	6	0	6
Gjithsej	779	358	1137

**Tab.2. Numri i institucioneve edukative-arsimore  
publike në Kosovë**

Numri i studentëve në arsimin e lartë ka shënuar rritje të ndjeshme në vitet e fundit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Institucioni	2014/15
Institucionet publike	82,225
Institucionet private	38,153
Gjithsej	120,378

**Tab.3. Numri i studentëve në arsimin e lartë në  
Republikën e Kosovës**

Pjesëmarrja e femrës në arsimin e lartë ka shënuar rritje. Në këtë vit akademik në arsimin e lartë publik është 53.3%, ndërsa në sektorin privat pjesëmarrja është 41.2%.

Viti akademik	Bachelor	Master	Doktoratë	Gjithsej
2014/15	262	180	26	468

***Tab. 4. Programet e akredituara të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës***